



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 4 dhe 9 korrik, në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, Kryetarja caktoi panele të apelit për të vendosur në lidhje me pesë apele, të cilat që të gjitha kanë të bëjnë me mënyrën se si ka interpretuar Trupi Gjykses zbatimin e rregullës 149, që ka të bëjë me dëshminë e dëshmitarëve ekspertë.

Kjo vjen në vijim të vendimeve të mëparshme të Trupit Gjykses më 1 dhe 7 korrik, me të cilët ai miratoi pjesërisht kërkesën e ekipeve të Mbrojtjes për të apeluar këtë aspekt. Trupi Gjykses konstatoi se zgjidhja e këtij aspekti mund të ndikonte në drejtësinë e procesit, si dhe në mënyrën se si duhet t'i trajtojë Trupi Gjykses këto dëshmi kur të vlerësojë peshën dhe vlerën provuese të tyre.

Për shqyrtimin e të pesë apeleve, në panel janë caktuar gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 3 korrik, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave për pranimin e tri aktekspertizave, pasi Mbrojtja e Viktimave nuk parashihte t'i thërriste autorët e këtyre raporteve për të dhënë dëshmi. Sipas Rregullores, Mbrojtja duhet të ketë mundësinë ta ballafaqojë autorin e një aktekspertize në sallën e gjyqit, përveç nëse Mbrojtja nuk kundërshton që aktekspertiza të pranohet pa dhënie të dëshmisë gojore nga dëshmitari ekspert përkatës. Trupi Gjykses e shtyu marrjen e vendimit për tri aktekspertizat e tjera deri pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarëve ekspertë të thirrur prej Mbrojtjes së Viktimave, të cilët janë autorë ose bashkautorë të aktekspertizave përkatëse.

Në atë vendim, Trupi Gjykses miratoi edhe kërkesën e Mbrojtjes së Viktimave që dy dëshmitarë ekspertë të japin dëshmi së bashku dhe caktoi që dëshmia e tyre të fillojë më 16 korrik, dhe nënvizoi se, duke mbajtur parasysh natyrën e kufizuar të kërkesës së Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave, gjykimi pritet të kalojë në fazën vijuese.

Më 4 korrik, Mbrojtja e Viktimave njoftoi Trupin Gjykses se parashikon që dëshmia e dy dëshmitarëve ekspertë të zgjasë dy orë, pas të cilit Prokuroria ka njoftuar se do t'i nevojiten dy orë për të bërë pyetjet e veta, ndërsa Mbrojtja parashikon se do t'i nevojiten pesë orë për pyetjet e saj.

Më 9 korrik, Trupi Gjykses pranoi si prova deklaratat dhe provat e disa viktimave me kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave, pasi ato lidhen me zhdëmtimin e viktimave për dëmet e pësuar. Trupi Gjykses refuzoi pranimin e disa provave materiale shoqëruese të propozuara nga Mbrojtja e Viktimave pasi këto prova materiale u diskutuan në hollësi gjatë dëshmive të dhëna në gjykatë.





Në të njëjtën çështje gjyqësore, në fillim të kësaj jave u bë publik një vendim i Trupit Gjyqësor i datës 1 maj, me të cilin u pranua dëshmia me shkrim e një dëshmitari sipas rregullës 155.

Kjo rregull lejon pranimin e një deklarate me shkrim apo të transkriptit të dëshmisë së një personi që nuk është i disponueshëm për të dhënë dëshmi personalisht, për shkak të dëmtimeve fizike apo mendore ose për arsye të tjera bindëse, nëse përmbushen disa kushte.

Në vendim, gjykatësit vunë në dukje se, meqenëse Mbrojtja nuk do të jetë në gjendje t'i bëjë pyetje dëshmitarit, sipas rregullave Trupi Gjyqësor nuk mund të bazohet vetëm, ose në masë vendimtare, në dëshminë e dëshmitarit. Trupi Gjyqësor theksoi se do ta mbante parasysht këtë, së bashku me faktorët e tjerë të ngritur prej palëve, kur të përcaktonte peshën përfundimtare që do t'i japë (nëse do t'i japë peshë) dëshmisë së dëshmitarit. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor theksoi se ky dëshmitar dëshmon në lidhje me krimet dhe dëshmia e tij nuk është për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarve që pretendohen në Aktakuzë.

Në çështjen *Salih Mustafa*, më 9 korrik, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese rrëzoi kërkesën referuese më të fundit të paraqitur nga Salih Mustafa në lidhje me dënimin e tij, në të cilën Mbrojtja pretendonte se dënimi nuk ishte proporcional.

Në arsyetimin e vet, Paneli i Gjykatës Kushtetuese shpjegoi se, meqenëse parashtuesi nuk kundërshtoi proporcionalitetin e dënit të përcaktuar në Ligj për veprën penale, dhe as nuk paraqiti argumente që tregonin se dënimi i dhënë ishte tejet shproporcional në raport me veprën penale, gjykatësit konstatuan se kërkesa referuese nuk kishte provuar krijimin e ndonjë perceptimi për shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtuesit. Për rrjedhojë, Paneli i Gjykatës Kushtetuese e rrëzoi kërkesën referuese si të papranueshme.

Si kujtesë: dënimi fillestar i z. Mustafa me 26 vjet burgim u ul nga Paneli i Apelit në 22 vjet burgim në dhjetor 2023, dhe u ul më tej nga Dhoma e Apelit në 15 vjet burgim në 2024, në bazë të udhëzimeve që mori nga Dhoma e Gjykatës Supreme lidhur me dënimin.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, dhe në interes të parimit të procesit publik, Gjykatësi i Vetëm që mbikëqyr zbatimin e urdhrit për zhdëmtim urdhëroi Administratoren të dorëzojë versione të redaktuara publike të disa dokumenteve konfidenciale dhe njoftoi se do të dorëzohen edhe versionet publike të vendimeve që lidhen me to.

Z. Mustafa u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, në vitin 2022, dhe u urdhërua t'u paguante shumën e gjithsejtë prej 207,000 eurosh viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor, si kompensim për dëmin e shkaktuar. Deri më tani, urdhri për zhdëmtim është zbatuar pjesërisht dhe viktimat pjesëmarrëse kanë marrë një përqindje të zhdëmtimit të urdhëruar për ta, me përjashtim të një viktime që nuk dëshiron të marrë zhdëmtim.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr. 27/2025
Hagë, 10/07/2025

Në çështjen Pjetër Shala, Paneli i Apelit do të shqiptojë aktgjykimin të hënën e ardhshme, 14 korrik, në orën 11:30. Seanca do të jetë publike dhe mund të ndiqet në gjuhët shqipe, serbishte ose anglishte përmes faqes së internetit të DHSK-së me 10 minuta vonesë, ose nga galeria për publikun në mjediset e gjykatës.

